

Programet për menaxhimin e pemishteve

Bujqësia çdo ditë e më shumë është duke u zhvilluar, me zhvillimin e bujqësisë po rritet nevoja edhe për paisje më moderne të cilat i mundësojnë fermerit që ti përfundojë punët më shpejt, më sakt dhe me më pak hargjime. Në ditet e sotme perdorimi i teknologjis së avancuar është i madhë, edhe tek ne në Kosovë ka filluar që të përdoren programe të avancuara. Programet i mundesojnë fermerit menaxhimin e pemishtes: planifikimin, monitorimin e motit dhe gjetjen e semundjeve, të dhënat mbi ekonomizimin e fermës, të dhëna mbi burimet dhe pasuritë, regjistrimin e resurseve, rritja analitike, reportet dhe kontrollin e makinerive, etj.

Menaxhimi i prodhimit, te mbjellurave, te korrurave

Këto programe i mundesojnë fermerit që në fermë shumë më lehtë të planifikoj, të monitoroj dhe të analizoj. Levrimi, mbrotja e produkteve, plehrimi, ujitja, vjelja dhe të gjitha këto mund të menaxhohen përmes këtyre programeve. Gjithashtu fermeri mundet me percjellë të ardhurat sipas sasisë, çmimit dhe të llogarisë punën për orë për çdo aktivitet.

Disa prej programeve të cilët i mundësojnë farmerit ti kryej këto punë janë:

- Cropio (www.cropio.com)
- EasyKeeper (www.easykeeper.com)
- Agrivi (www.agrivi.com)
- Plantator System (en.plantator.com/)
- Agri360 (www.agrimap.com/)
- FarmLogics (www.agrnavia.com)
- etj

<http://www.capterra.com/farm-management-software/> (Në këtë link mund të informoheni për më gjerësisht për programet e më sipërme)




Kontrollimi i Motit dhe Gjetja e Insekteve: Mund të shikoni të dhënat e motit për 1 javë dhe 3 vitet e historisë të të gjitha fushave. Zhvillimi i sëmundjeve dhe insekteve mund të detektohen përmes algoritmave të alarmit nëse në fushë ka ndonjë rrezik nga insektet dhe sëmundjet.

Ekonomia e fermes: Këto programe i mbajnë të dhënat dhe dokumentet në një vend të njëjtë. Fermeri mund të l gjurmoj shitjet, shpenzimet dhe investimet kapitale dhe mund ti i ndajë ato sipas prodhimit për kulturë (pemë, perime, etj).

Inventarizimi i burimeve: Me këto sisteme është e mundur krijimi i një regjistri për puntorë, për puntorë sezonal, makina etj. Pastaj për komplekse fushash dhe parcela më të vogla si edhe për secilën kulturë veç e veç me çka fermerit i mundësohet kontrollë më e lehtë mbi këto resurse. Poashtu ky system mundëson regjistrin mbrenda depove për ruajtje si edhe të paisjeve të nevojshme, pra fermerët arrijnë të identifikojnë në kohë nevojat si dhe të mësojnë gjendjen reale dhe të operojnë me lehtësi.

Analiza e rritjeve dhe raportimet: Me këto sisteme arrihet që të përcillen trendet e rritjeve dhe të gjinden dallimet në mes parcelave dhe kulturave. Poashtu mund të analizohet dhe gjinden shkaktarët e ngecjes apo rritjes krahasuar me një tjetër si dhe mund të mësohet se nga cila kulturë ka të ardhura më të larta. Këto raporte mund të mirren në PDF, Excel apo Word format.



Bsc. Erzen Shehaj - Bachelor- Prodhimtari Bimore - Intern RECURA Agro